




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM  
Nr.16, datë 19.09.2024



PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA  
SHOQËRIA "L.N.K" SH.P.K TEK SHOQËRIA  
"Anta En 2015" SH.P.K.**

Në mbështetje të shkronjës "b" të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.2C, datë 24.6.2008 "Leje për përdorim rezerve ujore për prodhim energjie, HEC SLLABINJË",

**Nga shoqëria "L.N.K" sh.p.k me Nipt K02003004P tek shoqëria "Anta En 2015" sh.p.k me Nipt L5151100IE,**  
me vendndodhje: Përroi Dushnë - Lumi Shkumbin. Pogradec.

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

KRYETARI I KBUSH KUMBIN

ALI MYSLIU

